



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË KLLOKOTIT PËR VITIN 2021

Prishtinë, maj 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Kllkotit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Kllkotit (KLI), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kllkotit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Në Raportin Vjetor Financiar, pasuritë kapitale të prezantuara në vlerë 1,318,714€, janë të nënvlerësuara për 409,977€ për shkak të mos regjistrimit të pasurive.
- B2 Në Raportin Vjetor Financiar, llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në vlerë 739,223€, janë të nënvlerësuara për 30,673€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Klllokotit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- B3 Komuna nuk kishte arritë të bëjë verifikimin e 20% të pronave të tatueshme.
- B4 Komuna gjatë vitit 2021 kishte angazhuar 53 zyrtarë për shërbime të veçanta pa udhëhequr procedura të prokurimit.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Klllokotit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Klllokotit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Klllokotit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Klllokotit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Klllokotit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të mundshme, rreth menaxhimit financiar dhe Kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: të hyrat, angazhimi i punonjësve pa zhvilluar procedurat adekuate ligjore, vonesa në kryerjen e pagesave, të arkëtueshmet, dobësi në regjistrimin e pasurisë jo financiare, përfshirë edhe kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Po ashtu, procesi i raportimit në komunë është përcjellë me mangësi, kjo është vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) të cilat kishin edhe gabime tjera, të cilat janë vërejtur gjatë auditimit dhe pas sugjerimeve tona janë bërë korigjimet e mundshme. Megjithatë, çështjet që ndërlidhen me llogaritë e arkëtueshme dhe menaxhimin e pasurive, janë paraqitur jo saktë në PFV. Gjetjet dhe rekomandime kanë për qëllim të përmirësojnë informacionin financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me gjashtë (6) rekomandime, të gjitha janë të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Mos regjistrimi i pasurive në regjistrat përkatës si dhe mos prezantimi i plotë i tyre në PFV

Gjetja

Sipas Rregullores Nr. 02/2013 - "Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore", neni 6, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria", po ashtu neni 6 i Rregullores Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: "Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjisllacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare.

Pasuria kapitale me vlerë mbi 1,000€ ishte nënvlerësuar për 409,977€, nga kjo shumë 107,426€ janë pasuri për blerje të vitit 2021 si asfaltimi i rrugëve, ndërtimi i objekteve të ndryshme, pajisje të ndryshme etj., ndërsa 302,551€ janë pasuri të blera në vitet paraprake, të cilat nuk ishin regjistruar në regjistrin kontabël të pasurive. Po ashtu, për pasuritë me vlerën nën 1,000€, komuna nuk ka evidenca (regjistër) dhe nuk dihet vlera e pasurive, softueri e-pasuria nuk është funksional, gjithashtu për stoqe komuna nuk ka të dhëna.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme të komunës sa i përket menaxhimit të pasurisë, si dhe

neglizhencës së menaxhmentit për ta trajtuar këtë çështje.

Ndikimi Mos regjistrimi i pasurive në regjistrat përkatës, rritë rrezikun që komuna mos të ketë nën kontroll, të gjitha asetet e saj dhe të ketë mangësi në raportim duke bërë nënvlerësimin e pasurive në PFV.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë se, zyrtari i pasurisë bën regjistrimin e plotë të pasurisë jo financiare dhe mirëmban regjistrat e pasurisë që disponon Komuna. Po ashtu, kryetari duhet të sigurojë evidenca të plota dhe të funksionalizoj sistemin e-pasuria në mënyrë që pasuritë nën 1,000€ dhe stoqet të regjistrohen me vlerën e tyre të saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Nënvlerësimi i Llogarive të Arkëtueshme në PFV

Gjetja Sipas Rregullores MF-Nr. 01/2017, për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore, Neni 16 përcakton se, organizatat buxhetore që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave.

Llogaria e arkëtueshme e prezantuar në PFV ishte nënvlerësuar për 30,673€, si pasojë e mos prezantimit të llogarisë së arkëtueshme për taksën nga shërbimet e ofruara për largimin e mbeturinave.

Sipas Komunës, mungesa e shënimeve të sakta nga departamentet përkatëse të mbledhjes së të hyrave që u janë përcjellë departamentit të financave, ka bërë që të arkëtueshmet e paraqitura në PFV të nënvlerësohen për shumën e plotë të arkëtueshmeve nga shërbimet e grumbullimit të mbeturinave.

Ndikimi Dobësitë e identifikuar ndikojnë në shpalosjen jo të saktë të llogarive të arkëtueshme në PFV. Po ashtu, informatat e pasakta ndikojnë edhe në vendimet e padrejta që mund ti ndërmer komuna për ti menaxhuar këto llogari.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të shtoj kontrollet gjatë përgatitjes së PFV në mënyrë që tabelat dhe shpalosjet për vitin 2022 të mos përmbajnë gabime. Po ashtu, duhet të sigurohet se deklarata e dhënë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar nuk nënshkruhet nëse nuk janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme sipas draft PVF-ve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B3 - Mosverifikimi i plotë i pronave komunale

Gjetja Sipas nenit 15.2 të Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20%, e të gjitha pronave brenda territorit të Komunës.

Komuna kishte faturuar tatimin në pronë nga sistemi Protax, për 877 objekte dhe 1016 parcela, por nuk kishte arritë të bëjë verifikimin për asnjë objekt apo parcelë.

Sipas zyrtarëve komunal mos verifikimi i pronës kishte ndodhur në mungesë të stafit dhe të sigurimit të teknologjisë e cila nevojitet për përkrahje të sistemit të tatimit në pronë.

Ndikimi Mos verifikimi i pronave për qëllim të tatimit në pronë, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës aktuale të tatueshme si dhe të ndikojë në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë rritjen e aktiviteteve për verifikim të pronave të paluajtshme, sipas kërkesave ligjore, në mënyre që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Angazhimi për shërbime të veçanta pa procedura ligjore

Gjetja Ligji për zyrtarët publik Nr. 06/L-114 në neni 84 thekson se Marrëveshjet për shërbime të veçanta, lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik. Sipas paragrafit 4 të ndryshim plotësimit të rregullave të KRPP-së për prokurim të shërbimeve të veçanta (konsulent/kontraktorët individual) këto rregulla aplikohen vetëm për prokurimin e shërbimeve të veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit.

Komuna gjatë vitit 2021 kishte angazhuar 53 zyrtarë për shërbime të veçanta. Këta zyrtarë ishin angazhuar për pozitat si: zyrtarë për buxhet dhe financa, zyrtar në drejtorinë e bujqësisë, pastaj në shëndetësi, shërbimeve publike, etj. Të gjithë punëtorët e angazhuar, janë kontraktuar pa udhëhequr procedurë të prokurimit.

Lidhur me çështjen e përmendur, nuk ka sqarim konkret nga ana e zyrtarëve komunal, pse nuk kanë zbatuar procedurat e përcaktuara.

Ndikimi Anashkalimi i procedurave të prokurimit në lidhje me mbulimin e pozitive për shërbime të veçanta, rritë rrezikun e angazhimit të personave jo adekuat për pozita dhe detyra të caktuara, e cila mund të reflektoj edhe në performancën e tyre në punë.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e punonjësve për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jenë në gjendje të përmbushin detyrat e kërkuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2021 ka shpalosur Llogari të Arkëtueshme në vlerë prej 739,223€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë prej 611,447€, nga qiraja në vlerë prej 6,915€, dhe taksa komunale për biznese 120,861€.

Çështja B5 - Menaxhim jo i duhur i llogarive të arkëtueshme

- Gjetja** Sipas ligjit Nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme me nenin 30 pika 1 është përcaktuar se nëse pas njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve kalendarike nga dita e fundit për pagesë, në përputhje me paragrafin 1. të nenit 27 të këtij Ligji, pagesa ende nuk është bërë, komuna merr vendim mbi ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara që kanë kaluar shumën e treqind euro (300€). Vendimi merret brenda dhjetë (10) ditëve pune.
- Nga 70 mostrat e testuara për të arkëtueshmet nga tatimi në pronë, në 46 raste borxhet nuk janë shlyer me vite, kështu që borxhi i secilit prej tatimpaguesve, individualisht kalon vlerën prej 300€. Komuna, megjithatë, në asnjë rast nuk ka iniciuar procedurë të arkëtimit të detyrueshëm, për këtë arsye trendi i rritjes së të arkëtueshmeve është në rritje nga viti në vit.
- Mungesa e përgjegjësisë së zyrtarëve komunal për ndërmarrjen e veprimeve konkrete ligjore përfshirë paralajmërimet e fundit para mbledhjes së detyrueshme, ka shkaktuar mos shlyerjen borxheve vite me radhë.
- Ndikimi** Mos zbatimi i ligjit dhe rregulloreve që i japin komunës të drejtën për inkasimin e të arkëtueshmeve, ndikon në rritjen e vazhdueshme të shumës së të arkëtueshmeve, në pamundësinë e realizimit të planeve komunale, si dhe inkurajon borxhlinjët tjerë që të mos përmbushin obligimet e tyre.
- Rekomandimi B5** Kryetari duhet të sigurojë se do të ndërmerren të gjitha masat ligjore për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme nga të gjithë pronarët e pronave konformë kërkesave ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2021, ishte 49,185€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2022.

Çështja B6 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja

Me nenin 39 të LMFP, kërkohet që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallrat dhe shërbimet, shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Nga testimi i shtatë mostrave në vlerë prej 12,250€, faturat nuk ishin paguar në afatin ligjorë prej 30 ditësh. Vonesat janë prej 30 ditë deri më tepër se 3 vite.

Sipas zyrtarëve komunal, Shkaku i mos pagesave me kohë ishte mungesa e mjeteve. Megjithatë, për faktin që detyrimet e papaguara datojnë për disa vite, kjo tregon se komuna nuk ka marrë përgjegjësinë që të kryej këto detyrime.

Ndikimi

Mos pagesa e detyrimeve brenda afatit ligjor rrit mundësinë që furnitorët ti drejtohen përbaruesve dhe gjykatave të cilat krijojnë shpenzime shtesë për buxhetin e komunës. Njëkohësisht, kjo mund të ketë ndikime buxhetore në projektet apo shpenzimet tjera operative.

Rekomandimi B6

Kryetari të sigurohet që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor dhe porositja e mallrave, punëve apo shërbimeve bëhet vetëm atëherë kur komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁴	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	1,084,567	1,241,393	1,174,251	1,356,585	1,289,491
Grante Qeveritare - Buxheti	940,512	998,186	992,520	1,263,536	1,137,347
Financimi përmes huamarrjes	0	2,457	2,457	5,040	0
Të bartura nga viti i kaluar	0	96,353	95,925	38,058	21,356
Të hyrat vetanake	144,055	144,055	83,350	38,057	130,788
Donacionet e jashtme	0	343	0	11,895	0

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 156,827€, rritja është rezultat i rritjes së grantit qeveritar në shumën prej 60,294€, si dhe të hyrave vetjake të bartura nga viti i kaluar në shumën prej 96,533€.

Në vitin 2021 Komuna ka shpenzuar 95% të buxhetit final, me një përmirësim prej 4% në krahasim me vitin 2020. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	1,084,567	1,241,393	1,174,251	1,356,585	1,289,491
Pagat dhe mëditjet	771,474	831,605	831,605	801,697	775,622
Mallrat dhe shërbimet	130,000	160,584	160,216	147,766	125,695
Komunalitë	50,000	65,000	40,068	24,538	45,261
Subvencionet dhe transferet	9,837	24,837	24,837	278,445	12,642
Investimet Kapitale	123,256	159,368	117,526	104,138	330,271

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për Paga dhe Mëditje ishte rritur për 60,131€, krahasuar me buxhetin fillestar, kjo rritje është nga granti qeveritar 57,674€, si dhe 2,457€ nga fondi i financimit përmes huamarrjes.
- Buxheti final për Mallra dhe Shërbime ishte rritur për 30,584€, krahasuar me buxhetin fillestar, kjo rritje është nga të hyrat vetanake të bartura nga viti i kaluar për 30,424€, si dhe 160€ nga të hyrat e vitit aktual.
- Buxheti final për Komunalitet ishte rritur për 15,000€, nga të hyrat e bartura nga viti i kaluar.
- Buxheti final për Subvencione dhe Transfere ishte rritur për 15,000€, nga të hyrat e bartura nga viti i kaluar.
- Buxheti final për Investime Kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 36,111€, kjo rritje është nga të hyrat e bartura nga viti i kaluar.
- Mjetet e shpenzuara në vitin 2021 për Rimëkëmbjen Ekonomike ishin 21,462€, ato kryesisht ishin ndarë për shtesa në arsim dhe shëndetësi.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2021 ishin në vlerë 139,492€ dhe kanë pasur një rritje prej 9,757€ në krahasim me vitin 2020. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Përveç të hyrave direkte, komuna kishte realizuar edhe të hyra indirekte nga gjobot në trafik në vlerë prej 4,593€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	144,055	144,055	139,492	129,735	163,116
Të hyrat tatimore	74,151	74,151	59,784	22,671	83,989
Të hyrat jo tatimore	69,904	69,904	79,708	107,064	79,127

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2020, ka rezultuar me (9) nëntë rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit i vitit 2020 nuk është diskutuar në Asamblenë Komunale.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, tri (3) rekomandime janë zbatuar gjashtë (6) nuk janë zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se, zyrtari i pasurisë bën regjistrimin e plotë të pasurisë jo financiare dhe mirëmban regjistrat e pasurisë që disponon komuna. Po ashtu, kryetari duhet të sigurojë se funksionalizohet sistemi e-pasurisë në mënyrë që pasuritë nën 1,000€ dhe stoqet të regjistrohen me vlerën e tyre të saktë.	Komuna nuk kishte ndërmarrë masa për të adresuar këtë rekomandim.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të shtoj kontrollin gjatë përgatitjes së PFV në mënyrë që tabelat dhe shpalosjet për vitin 2021 të mos përmbajnë gabime. Po ashtu, duhet të sigurohet se deklarata e dhënë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar nuk nënshkruhet nëse nuk janë zbatuar të gjitha kontrollin e nevojshme sipas draft PVF-ve.	Komuna nuk kishte ndërmarrë masa për të adresuar këtë rekomandim.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të ndërmerr masa për të siguruar se llogaritë e arkëtueshme janë të evidentuara saktë dhe me kohë, dhe të bëhet prerja në fund të vitit në mënyrë që në kohën e përgatitjes së PVF-ve për vitin 2021 vlera e tyre të shpaloset saktë. Po ashtu, duhet të ndërmerren të gjitha masat ligjore për arkëtimin e LL/A tjera nga të gjithë pronarët e pronave.	Komuna nuk kishte ndërmarrë masa për të adresuar këtë rekomandim.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave pasi që mbledhja e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës.	Komuna nuk kishte ndërmarrë masa për të adresuar këtë rekomandim.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se angazhimi i zyrtarëve me marrëveshje për shërbime të veçanta bëhet në përputhje me kërkesat ligjore duke aplikuar procedurën adekuate të prokurimit, për të siguruar se personeli i angazhuar do të jetë në gjendje të përmbushin detyrat e kërkuara.	Komuna nuk kishte ndërmarrë masa për të adresuar këtë rekomandim.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të siguroj se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet malli/shërbimi dhe të kryhet pagesa.	Komuna ka ndërmarrë masa për të adresuar këtë rekomandim.	I zbatuar
7.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se aprovet rregullorja e brendshme, po ashtu kryetari duhet të sigurojë se komisionet përkatëse themelohen dhe raportet e dalura nga këto komisione përgatiten dhe harmonizohen me regjistrat e pasurisë para përgatitjes së PFV-ve për vitin 2021.	Komuna ka ndërmarrë masa për të adresuar këtë rekomandim.	I zbatuar
8.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha faturat e pranuar të regjistrohen në librin e protokolleve për të përmbushur kërkesën e ligjit për protokollimin e dokumenteve. Gjithashtu, kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në mënyrë që raportimi i detyrimeve ndaj Thesarit të bëhet në baza mujore.	Komuna nuk kishte ndërmarrë masa për të adresuar këtë rekomandim.	Nuk ka filluar zbatimin
9.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë që aktivitetet e komunës i nënshtrohen auditimit të brendshëm, që synon shtimin e vlerës dhe përmirësimin e funksionimit të Komunës, që ndihmon në përmbushjen e objektivave, duke ofruar qasje sistematike, të disiplinuar, për të vlerësuar dhe përmirësuar efektshmërinë e proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.	Komuna kishte arritur të sigurojë shërbimet e auditimit nga Njësia Qëndrore Harmonizuese.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm




Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit




Ejup Simnica, Udhëheqës i ekipit



Milos Petrovic, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër confirmimi



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA E KOSOVES
OPŠTINA KLOKOT / KOMUNA E KLLKOTIT
Nr. 707/1 dt. 26.05.2022
KLOKOT / KLLKOT

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Kllkot / Opština Klokot / Municipality of Klokot

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjete Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit
Të nderuar,

Përmes kësajshkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Kllkotit, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohemme gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Vladan Bogdanovic *Vladan Bogdanovic*
Kryetar i Komunes se Kllkotit,
Data: 26.05.2022, Kllkot,



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁵ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁶, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.